



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 547/1 prot.

Tiranë më 26.3.2018

Lënda: Mendim mbi projektvendimin "Për miratimin e rregullores "Për disenjot industriale".

Z. ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

I nderuar Z. Ahmetaj,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 5680 Prot., datë 20.03.2018, projektvendimi "Për miratimin e rregullores "Për disenjot industriale", vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Vlerësojmë që në tërësinë e projektvendimit të përdoren terma në përputhje me ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Sa më sipër, sugjerojmë që paragrafi i parashikuar në pikën 6 të nenit 46 të projektvendimit, të zëvendësohet me: "Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë, të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar."

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

